



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONERI PËR MBROJTJEN E TË DHËNAVE PERSONALE
Drejtoria e Shërbimeve Mbështetëse

Nr. _____ Prot.

Tiranë, më _____ 2012

RELACION

Lenda: Mbi Performancën Financiare Buxhetore të KMDP-se për vitin 2012

Komisioneri për Mbrojtjen e të Dhenave Personale, në zbatimin e buxhetit të vitit 2012, është mbështetur në kërkesat me të domosdoshme institucionale, në zbatim detyrimeve që rrjedhin nga zbatimi i Ligjit Nr.9887, datë 10.03.2008, “Për mbrojtjen e të dhenave personale”.

Komisionerit për Mbrojtjen e të Dhenave Personale, në lidhje me performancën financiare buxhetore, ka vepruar me korrektesë në zbatim të Ligjit nr.10487 datë 05/12/2011”Për buxhetin e vitit 2012”, i ndryshuar ,udhëzimit nr.2,date 6/02/2012”për procedurat standarde të zbatimit të buxhetit “ si dhe Udhëzimit nr,2/1 datë 15/02/2012,”Për zbatimin e buxhetit të vitit 2012’,

Në mbështetje të Ligjit nr. 10487 datë 05/12/2011”Për buxhetin e vitit 2012” ,për vitin 2012, është miratuar për Komisionerin për Mbrojtjen e të Dhenave personale 1 program buxhetore :

- Programin me emertimin « Planifikim, menaxhim dhe administrim » ku përfshihet i gjithë buxheti i akorduar për funksionimin e aktivitetit të Zyres së Komisionerit për mbrojtjen e të Dhenave Personale

Programi “Planifikim, Menaxhim dhe Administrim”

Buxheti i akorduar për këtë program ka në bazë të tij Deklaratën e Politikës (DPP) së hartuar gjatë procesit të PBA 2011-2014 . Ky buxhet është në funksion të realizimit të politikës së përcaktuar në DPP: Mbështetja, organizimi, krijimi i kushteve të nevojshme për mirëfunksionimin e KMDP, përafrimin e harmonizimi legjislativ në fushën e të dhenave personale me legjislativin e vendeve të tjera të komunitetit evropian, me të drejtën komunitare si dhe privatesinë, imponimi i legjislativit të sotëm ekzistues vendas si dhe ndergjegjesimin dhe shtrirjen e fushës së zbatimit të ligjit në të gjithë vendin duke garantuar një transparencë totale të përpunimit dhe garantimit të të dhenave , siguri maksimale të të dhenave personale ,intensifikimi i marrëveshjeve me strukturat e BE duke garantuar maksimalisht mbrojtjen e të dhenave personale të shtetasve në levizje ose rezident në BE. administrimi e menaxhimi i regjistrit elektronik dhe fizik të subjekteve kontrollues, monitorimin, rekomandimin dhe investigimet në kuadrin e mbrojtjes së të dhenave personale,mbi të cilat KMDP zhvillon përgjegjësitë e saj ligjore, për të garantuar maksimalisht të drejtat dhe liritë themelore të njeriut .

Në zbatim të udhëzimit nr.2/1 datë 15/02/2012, "Për zbatimin e buxhetit të vitit 2012", kreu 6-Raportet e Monitorimit, pika 254,256,257, po ju raportojme mbi performancën e produkteve të buxhetit për periudhën Janar-Mars 2012, sipas modeleve standarte të monitorimit.

Gjithashtu ky buxhet ka për qëllim ndërmarrjen e veprimeve të caktuara në funksion të realizimit të produkteve dhe arritjes së objektivave të përcaktuara për këtë program buxhetor.

Komisioneri për Mbrojtjen e të Dhenave personale, në bazë dhe për zbatim të regjstrit të parashikimeve të vitit 2012, për periudhën 3 muajore ka prokuruar:

KMDP i është akorduar një fond i planifikuar prej **45.177 . në mijë leke**, me ndryshimet e rialokimeve përbehet nga:

Fondi i Pagave:	27.651 mijë leke (zeri 600)
Fondi i Sigurimeve Shoqerore:	4.754 mijë leke (zeri 601)
Fondi për Shpenzime Operative	9.367 mijë leke (zeri 602)
Fondi për Investime:	3.000 mijë leke (zeri 231+230)
Transferime korrente	420 mijë leke (zeri 606)
Kuotizacione	30 mijë leke (zeri 605)

Nga fondi i përgjithshëm buxhetor, për periudhën e raportuar, Komisioneri për Mbrojtjen e të Dhenave personale, ka realizuar vlerën buxhetore në **8147 në mijë lekë** ose 18%, të fondit të planifikuar vjetor.

Fondi i Pagave dhe Sigurimeve Shoqerore, (zeri 600-601), është realizuar në zbatim të strukturës organizative të miratuar, Nr. 225 dt. 13.11.2008 "Për miratimin e strukturës, organikes dhe kategorizimit të pagave të pozicioneve të punës së Komisionerit për Mbrojtjen e të Dhenave Personale numri mesatar i punonjësve është realizuar 28 vetë, nga 29 vetë të miratuar. Shmangiet nga plani kanë ardhur si rezultat i ripërsëritjes së procedurës së rekrutimit. Pas verifikimit të dokumentacioneve, procedurave të ndjekura të konkurimit, vlerësimit të rezultateve të testimit, kandidatet e testuar, nuk arritën të vlerësoheshin në nivelin minimal të mjaftueshëm për rekrutim, në pozicionin e Specialistes së Mardhënieve me jashtë pranë Dejtorisë së Çështjeve Procedurale Ligjore dhe Mardhënieve me Jashtë. Aktualisht kanë rifilluar procedurat e rekrutimit, në zbatim të Ligjit nr.8549, dt. 11.11.1999" Statusi i nepunësit

Nga fondi i përgjithshëm i pagave si dhe i sigurimeve shoqerore, për këtë periudhë, është realizuar respektivisht 6517 (në mijë leke) për paga si dhe, 992 në mijë leke për kontribute në sigurimet shoqerore e shëndetësore ose 92 % e fondit të planifikuar tremujor ose 23 % kundrejt planit vjetor . .

Fondi për shpenzim investime (zeri 231), nga vlera e përgjithshme prej 3,000 (në mijë leke) për periudhën e raportuar, është prokuruar dhe por ende nuk janë kryer pagesat .

Gjatë vitit 2012, objektivat prioritarë në drejtim të DSHM është dhe mbetet ndjekja e realizimit të procedurave të prokurimeve në mbështetje të Ligjit nr.9643 datë 20.11.2006 "Për prokurimin Publik", i ndryshuar, udhëzimit nr.2 "Për procedurën e blerjeve të vogla", mbi bazën e kërkesave dhe fondeve të alokuara sipas projekteve të miratuara e për investime e konkretisht janë realizuar investimet e mëposhtme.

- Ndjekja dhe përfundimi i procedurave “Blerjen orendi zyre”, per plotësimin e krijimin e kushteve te pershtashme te punes se punonjësve , mobilim te salles se trajnimeve dhe studimeve si dhe arredim te recepsionit dhe pritjes se publikut dhe kontrolluesve publike e private.
- Ndjekja e procedurave me objekt prokurimi “Ndetimi i sistemit te menaxhimit te ceshtjeve te regjistrimit te kontrolluesve dhe proceduar e inspektimit “ alokuar nga ministria e Financave ne Projektin “Intranet” realizuar ne vleren 2.000. ne mije leke. Jane ndjekur procedurat e tenderimit me proceduren “Kerkese me prpozim” e pas deshtimit te tij ,si rezultat i mungeses se konkurences ka rifilluar perseri kjo procedure online.

Fondi per shpenzime ne zerin Mallra dhe Shërbime (zeri 602), per vitin 2012, eshte planifikuar ne vleren 9367 (ne mije leke),me ndryshimet perkatese te miratimit per rialokim ,nga fondi i vecante. Edhe per kete ze, per periudhen respektive eshte realizuar vlera prej 533 ne mije leke ,rreth 30 %, e planit 3- mujor , duke respektuar kerkesat e detajuara ne Regjistrin e Prokurimeve Publike, te miratuara edhe nga Agjensia e Prokurimeve Publike.

Plani eshte realizuar ne kete mase , pasi kjo eshte shifer vetem e pagesave kaluar ne banke , ku per nje pjese pjese te madhe te prokurimeve te perfunduara nuk jane kryer transaksinet tek furnitori si rezultat e vonesve te deges se thesrait ashtu edhe te kontratave vjetore te lidhura dhe procedurave 30 ditore te pritjes per pagesa.

Ne pasqyren sipas **Formatit Nr 6** eshte paraqitur plani vjetor si dhe realizimi vjetor ne nivel programi, e ndarë sipas zerave kryesore te buxhetit.

Formati nr 7-Aneksi 9

Realizimi dhe monitorimi i perdorimit te fondeve publike ne nivel te pergjithshem programi dhe realizimi ka qene ne masen 18 % .kundrejt vjetorit ose 73% kundrejt 3- mujorit. .

Aneksi nr 9

Formati nr 8

Ne kete format eshte paraqitur realizimi i produkteve(ne sasi) nga kryerja e aktiviteve ne zbatim te objektivave dhe strategjise së miratuar per vitin 2012.

Konkretisht :

Persa i perket **produktit F Sherbime te pergjithshme dhe infrastrukture** ,realizimi eshte shprehur ne nr. Ne vlere ne kete produkt jane perfshire sigurimi i sherbimeve te pergjithshme per te gjithë personelin , si furnizimi me uje, drita , telefon, sherbime sigurimi, sherbime abonimi per gjithë stafin si dhe furnizimi me mallra e sherbime te mbarevajtjes se punes se perditshme,kanceleri

,sherbime transporti,pjesemarrje ne trajnime brenda e jashte si dhe perfaqesime e pjesemarrje ne aktivite nderkombetare Gjithashtu pjese e saj eshte dhe ofrimi dhe krijimi i kushteve sa me te mira pune, nepermjet pajisjes se cdo punonjesi me asetet e nevojshme (orendi,informatike etj)

Produkti A Sherbime ligjore ,njesia matese e se ciles eshte nr.akteve te akte e udhezime te miratuara.sqarojme se per 3- mujorit e pare 2012 jane dhene mendime per akte ligjore e nenligjore gjithsej 7 mendime nga fusha e legjislacione te ndryshme. Ne kuader te perqasjes se legjislacionit te brendshem me Ligjin 9887, date 10.03.2008, jane pergatitur amendime t e 2 kodeve(Civil e Penal) , 3 ligjeve”bankar, Pransalimin e Pastrimit te Pdhe Financimit te terrorizmit, si dhe te ligjit “mbi nyumrin e identitetit te Sheteasve” dhe 1 rregulloreje “per permabajtjen e informacionit dhe funksionimit te te regjistrit te kredive ne banken e Shqiperise.Jane hartuar 4 projekt/udhezime dhe nje permbledhese kryesisht per policine e shtetit,sistemin bankar,ne sistemin shendetesor, si dhe permbledhesja , ne bashkepunim me D.P.Gjendjes Civile .jane hartuar 3 projekt /mareveshje bashkeounimi me Banken e Shqiperise,prokurorine e pergjithshme si dhe Komisionerin per mbrojtjen nga diskriminimi

Per kete produkt bejme me dije se deri ne miratimin e akteve te Komisionerit,Udhezime e hartime te kodeve me institucione ne sektore te vecante, kryhen nje sere veprimtarish si studim legjislacioni, hartim projekt udhezimesh, dhenie e marrje mendimi ,te cilat kerkojne afatet e tyre kohore deri ne finalizimin, miratimin e publikimin e tyre.

Eshte trajtuar nje kerkese per dhenie te Autorizimit te transferimit nderkombetar te te dhenave Personale.

Produkti B lidhur me ndergjegjesimin dhe rritjen e shkalles se tij si per te rinjte (duke perfshire kategorite e shkollave 9 vjecare ,te mesme te larta) si dhe opinionin ne rastin tone te quajttur subjekte .

Ndergjegjesimi eshte nje proces i gjate dhe i veshtire. Ai nuk mund te matet dhe nuk ka standarte vendase apo dhe te huaja per nivelin e tij. Sqarojme se kete numer e kemi vendosur vetem per pjeseamrresit aktual ne organizmimin e aktiviteteve , por qe mun te themi se cdo perfaqesues ne keto evente mund te perfaqesoje nje kategori me te madhe. Psh 100 pjesemarres te nje fakulteti tregon dhe nje sensibilim te gjithe te rinjve te atij fakulteti. Keshtu qe nuk mund te japim nje nivel ne % te rritjes se ndergjegjesimit. Ndoshhta ne vitet me pas mund te nxjerrim nje statistike lidhur me te.

Ky produkt realizohet nepermjet **seminareve ndergjegjesuaes** i cili mund te jete ne vetevete nje mates apo indikator mbi performancen Maredhenieve me Publikun. Identifikohen sa tille jane parashikuar dhe sa jane realizuar. Sa pjesemarres kane qene te interesuar dhe te sensibilizuar.

Gjate 3- mujorit te pare te vitit 2012 jane realizuar aktivite me rastin e Dites Europiane te mbrojtjes se te dhenave personale, prane universitetit Kristal,Marin Barleti takime me studente te degeve te gazetarise tte Universitetit te Tiranës , te cilet jane me te ndjeshem ndaj publikimit apo rasteve te shkeljeve te te dhenave personale, takime ne vende te hapura ku frekuentohen nga nja mase e gjere e publikut me subjektet e te dhenave personale te cilet informohen periodikisht mbi privatesine, rastet e shkeljes dhe garantimin nga ligji per mbrojtjen e te dhenave personale, atje ku ato ekspozohen, perpunohen apo transferohen ne kundershtim me ligjin. Gjithashtu ne kete produkt jane perfshire dhe emisionet televizive te herepashershme ,ne kuader te ndergjegjesimit te publikut.(Gjithsej 5)

Produkti C : Kontrollues publike e private te sensibiluar te fusha te ndryshme

Ky produkt eshte vednosur ne nr, kontrolluesih te trajnuar nepermejt seminareve te organizuar ne rrethin e Tiranes si dhe ne rrethe te ndryshme te vendit

Pjese e ktij produkti jane dhe takimet ,tavolinat e rumbullaketa ,seminaret e organizuara prane ambejnteve te zyrave te Komisionerit me kontrollues te fushave te ndryshme apo dhe semanre jashte zyrave ne ambiente sallash, te mundesuara nga Projekti IPA 2009, “Forcimi i Zyres se komisionerit per Mbrojtjen e te Dhenave Personale “e konktheisht projekti FIIAPP-PROGECO,me perfaqesues te kontrolluesve publike por edhe private

Ne kuader te rritjes se ndergjegjesimit te kontrolluesve publike e private ne lidhje me fushen e mbrojtjes se te dhaneve personale jane ndermarre aktivitetet ne qytetin e Tiranes si dhe ne rrethin e Vlores dhe te Fierit. me kategori te ndryshme kontrolluesish.

Gjitashtu ne kuader te sensibilizimit dhe ndergjegjesimit jane marre kontakte te vazhdushme me mediat , ku jane dhene njoftime mbi veprimtarine e Zyres se komisionerit.

Produkti D “Subjekte te regjistruar” njesia matese e se ciles eshte numer te regjistruarish subjektesh private e publike, eshte pjese e nje veprimtarie te gjere identifikimi,plotesimi informacioni para deklarimit zyrtar,vleresime ligjore te perpunimit te te dhenave personale te cilat do te perbejne bazen per evidentim te shkeljeve e shmangieve nga perpunimi i ligjshem dhe burim per hetim te metejshe,mareveshje institucionale me subjekte publike apo private per vendosjen e urave te komunikimit për sensibilizimin për njoftim, kontakte me media te shkruar e publikime te ndryshme ne deri ne formularin e njoftimit perfundimtar dhe regjistrimin ne regjistrin kombetar , i cili eshte burimi i vetem online i informacionit per publikun,me qellim informimin masiv dhe berjen transparente ndaj publikut se kush perpunon, pse dhe si.

Numri i njoftimeve per 3-mujorin e pere eshte 131 dhe i te regjisstruarve 123 ,prej te cileve 103 jane te sektorit privat dhe 20 nga sektori publik. .

Produkti E Inspektime dhe trajtim ankesash, njesia matese e te cilit eshte numer, eshte pjese e nje veprimtarie te gjere e cila perfshin kontrole tematike te planifikuara, publik apo private ,si dhe hetim e trajtime mbi baze ankesash te ardhura ne forma te ndryshme ,monitorime e ndjekje rekomandimesh te vendosura nga Zyra e KMDP,monitorime te regjistrit te njoftimeve dhe ne rast mos deklarimi te ketij detyrimi ligjor,indicje per vendosje te masave administrative me gjobe, e ne perfundim ndjekja e procedurave per egzekutim te tyre

Inspektimet jane fokusuar dhe realizuar per pjesen me te madhe ne Rrethin e Tiranes pa nje kosto financiare sherbimesh si dhe nje kontroll prane ne rrethin e Lezhes..Ne kuader te realizimit te objektiveve ka vijuar puna per ndjekjen e rekomandimeve te lena nga kontrollet e ushruarar per vitin 2011.

Formati nr 9

Ne kete format eshte paraqitur realizimi i produkteve(ne vlere) nga kryerja e aktiviteve ne zbatim te objektiveve dhe strategjise se miratuar per vitin 2012.

Per cdo produkt eshte perfshire kosto e shpenzimeve per paga, sigurime, si dhe shpenzimet operative direkte te pjese marrjes.

Komisioneri per Mbrojtjen e te Dhenave Personale , ka zbatuar me korrektesi te gjitha detyrimet qe rrjedhin nga Ligji per mbrojtjen e te Dhenave personale te, si dhe legjislacionin administrativo-financiar shqiptar.

Drejtoresh e Sherbimeve Mbështetëse

Lindita Morina